



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 17 qershor 2010
Nr. ref.: RK 25/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI 13/09

Sevdail Avdyli

kundër

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006
dhe
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës, Sevdail Avdyli, me banim në fshatin Metehi, komuna e Podujevës.

Objekti i shqyrtimit

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se me Aktgjykimin A. Nr. 533/2006 të Gjykatës Supreme, të datës 11 shtator 2006, që e konfirmoi Vendimin Nr. 5004857 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e drejta e tij për pension invalidor është shkelur. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se me Aktgjykimin A. Nr. 533/2006 të Gjykatës Supreme, të datës 2 dhjetor

2003, që e konfirmoi Vendimin Nr. 809 të Qendrës për Punë Sociale të Podujevës, e drejta e tij për ndihmë sociale, gjithashtu është shkelur.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Kushtetuta); Neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Ligji) dhe Neni 54(b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme - Rregullorja e Punës).

Përmbledhje e procedurës në Gjykatë

4. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e vet në Gjykatën Kushtetuese më 16 mars 2009. Më 17 mars 2009, parashtruesi u informua nga Sekretariati i Përkohshëm i Gjykatës Kushtetuese se rasti i tij do të shqyrtohej pasi Gjykata të bëhet tërësisht funksionale.

5. Më 11 gusht 2009, Gjykata Kushtetuese ia komunikoi Gjykatës Supreme të Kosovës rastin e parashtruesit të kërkesës. Më 12 nëntor 2009, Gjyqtari Raportues kërkoj informata shtesë nga Gjykata Supreme. Gjykata Supreme nuk ofroi asnjë përgjigje.

6. Më 18 shkurt 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj, të njëjtën ditë i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, që rastin ta hidhte poshtë si të papranueshëm.

Faktet

7. Nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, shihet se në dhjetë vjetët e kaluara, ai kishte iniciuar dy procedura të ndryshme administrative: procedurën lidhur me kërkesën e tij për ta marrë pensionin invalidor dhe procedurën lidhur me kërkesën e tij për ndihmë sociale. Asnjëra procedurë e parashtruesit të kërkesës nuk ishte e suksesshme.

Sa i përket procedurës administrative lidhur me kërkesën e parashtruesit për pension invalidor:

8. Më 1 janar 2004, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale, fillimisht aprovoj kërkesën e parashtruesit për pension invalidor, në shumë prej 40 eurove në muaj. Parashtruesi gjithashtu u informua se vendimi do të shqyrtohej pas një viti. Pastaj, me Vendimin e datës 29 shtator 2005, i njëjti autoritet i anuloi përfitimet pensionale të parashtruesit të kërkesës, sepse gjeti se gjendja shëndetësore e parashtruesit të kërkesës nuk i lejonte atij të kualifikohej për pension invalidor. Më pas, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër këtij vendimi. Më 6 maj 2006, ky vendim u mbështet nga Këshilli për Ankesa mbi Pensionet Invalidore, pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

9. Më pas, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë mbi kontestin administrativ në Gjykatën Supreme. Në vendimin e vet, të datës 11 shtator 2006 (Nr. 1561/2007), Gjykata Supreme vendosi që ankesa dhe padia e parashtruesit të kërkesës ishin të pabazuara, pasi parashtruesi nuk i kishte përmbushur kriteret e nenit 3, të Ligjit mbi Pensionet Invalidore. Gjykata u bazua në mendimin e këshillës së mjekut, të lëshuar më 29 shtator 2004, sipas të cilit parashtruesi nuk kishte invaliditet të përhershëm. Ky konstatim mjekësor, u konfirmua nga komisioni mjekësor në procedurën e apelit. Pastaj, në pajtim me Nenin 40 të Ligjit mbi Kontestet Administrative, padia e parashtruesit u hodh poshtë.

Sa i përket procedurës administrative lidhur me kërkesën e parashtruesit për ndihmë sociale:

10. Lidhur me kërkesën e parashtruesit për ndihmë sociale, nga dokumentet shihet se më 15 gusht 2002, Departamenti i Punës dhe Mirëqenies Sociale i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, fillimisht e aprovoi kërkesën e parashtruesit që i lejonte atij ndihmë sociale në shumë prej 64 eurove në muaj. Ndihma sociale iu lejua për një periudhë të caktuar kohore, domethënë, prej 1 gushtit 2002 deri më 31 janar 2003. Më pas, më 12 maj 2003, i njëjti autoritet e hodhi poshtë kërkesën e mëtejme të parashtruesit për ndihmë sociale, duke argumentuar se, “një anëtar i familjes së tij nuk e kishte përmbushur njërin prej gjashtë kritereve”. Më pas, parashtruesi parashtroi ankesë kundër këtij vendimi.

11. Instituti për Politikë Sociale i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit dhe ia kujtoi se njëri prej vëllezërve të tij jetonte jashtë vendit dhe se disa anëtarë të familjes së parashtruesit të kërkesës, ishin në gjendje të punonin. Prandaj, u konkludua se parashtruesi nuk ka të drejtë për ndihmë sociale. Parashtruesi, parashtroi padi kundër këtij vendimi në Gjykatën Supreme.

12. Më 2 dhjetor 2003, Gjykata Supreme hodhi poshtë padinë e parashtruesit. Gjykata përsëriti se ishte vërtetuar që parashtruesi nuk i kishte përmbushur kushtet e parapara me skemën e Ligjit mbi Mbrojtjen Sociale dhe Ndihmën Sociale, të miratuar nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara.

Pohimet e Parashtruesit

13. Parashtruesi ankohet, pa përmendur asnjë dispozitë të posaçme të Kushtetutës, se të drejtat e tij për pension invalidor dhe ndihmë sociale, janë shkelur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata vëren se parashtruesi e paraqiti kërkesën pranë Sekretariatit më 16 mars 2009. Megjithatë, Aktgjykimet A. Nr. 353/2003 dhe A. Nr. 533/2006 të Gjykatës Supreme, që parashtruesi i dorëzoi në mbështetje të kërkesës së tij, janë të datës 2 dhjetor 2003, respektivisht 11 shtator 2006, kurse në pajtim me Nenin 49 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, kërkesa duhet të dorëzohet brenda katër (4) muajve. Edhe nëse supozohet që Gjykata do ta shrinte autoritetin e vet, për ta shqyrtuar kërkesën e parashtruesit mbi teorinë se shkeljet e supozuara të Kushtetutës nga parashtruesi mund të përbëjnë një situatë të vazhdueshme, Gjykata gjen se kërkesa duhet të hidhet poshtë për këto arsye:

15. Ankesa e parashtruesit kufizohet në mospajtimin e tij me konkluzionet e organeve administrative dhe të Gjykatës Supreme, të nxjerra mbi faktet e pohimeve të tij individuale dhe pretendimeve të tij se ato organe, si dhe Gjykata Supreme, me rastin e vlerësimit të pohimeve të tij, nuk i kanë shqyrtuar në mënyrë të duhur të gjitha faktet relevante.

16. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

17. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi ka pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i

Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. No. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

18. Në rastin konkret, parashtruesit i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit, që e konsideronte të pasaktë, para Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të dy procedurave administrative si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta, apo të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmerinë e kërkesës nr. 17064/06 të datës 30 qershor 2009).

19. Për më tepër, parashtruesi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi *prima facie*, që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmerinë e kërkesës nr. 53363/99 të datës 31 maj 2005).

20. Prandaj, kjo kërkesë nuk është e bazuar dhe duhet të hidhet poshtë,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit, si dhe Nenin 55 të Rregullores së Punës, në seancën e datës 17 qershor 2010, njëzëri:

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Mr.Sc.Kadri Kryeziu, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.